

Hapet Thirrja për Bursa për studentët dhe Stafin Akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Teknologjik Bialystok, Poloni në kuadër të Programit Erasmus +

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Teknologjik Bialystok, Poloni.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;
- Mësimdhënie për stafin akademik;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- Bachelor/Master (6 muaj);
- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit (për stafin);

Fushat e studimit:

- Informatikë dhe Teknologji Informacioni;

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit në gjuhën angleze të ofruar nga Universitetin Teknologjik Bialystok, klikoni në adresën:

<http://elam.pb.edu.pl/elam/2017/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (750 Euro në muaj për studentët)
- Kompensimin ditor për stafin 140 Euro;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor viti II dhe viti III:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1);
- *Learning Agreement;

*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Teknologjik Bialystok lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

*Kujdes: Studentët bachelor të vitit të I-rë nuk mund të aplikojnë.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

-CV (në gjuhën anglez);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti;

-Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1);

-Diplomë dhe listë notash të Bachelor-it;

-*Learning Agreement;

*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Teknologjik Bialystok lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV+ Listën e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze në nivelin B2;
- Plani i mobilitetit*;
- Vërtetim nga Dekani i fakultetit tuaj që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.

**Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:*
https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus/files/files/resources/mobility-agreement-teaching_en.pdf

KUJDES! Kur të sillni në rektorat planin e mobilitetit për t'u firmosur nga Koordinatori Institucional i Erasmus + për UT-në, Z. Elton Skendaj, duhet të bashkëngjisni edhe dokumentin e vërtetimit nga dekani juaj që ju lejon të shkëputeni gjatë kohës së mobilitetit.

Afati për aplikim: **15 Janar 2018**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!